

Fati Iseni, PhD<sup>1</sup>  
Agim Jakupi, MA<sup>2</sup>

UDC: 321.64/.7(495.6)"1989/1992"

**SHQIPËRIA NGA KOMUNIZMI NË PLURALIZËM (1989-1992)**

**АЛБАНИЈА ОД КОМУНИЗАМ ДО ПЛУРАЛИЗАМ (1989-1992)**

**ALBANIA FROM COMMUNISM TO PLURALISM (1989-1992)**

**Abstract**

This regime is known as one of the wildest regimes in Europe and the world. Based on the Marxist-Leninist Doctrine this regime and its suite led by dictator Enver Hoxha had good diplomatic relations in the beginning with Tito's former Yugoslavia until 1948, with which he severed diplomatic relations by declaring that "Yugoslav revisionists were neither for peace nor for socialism. They were linked to the imperialists and helped to overthrow the communist regimes in the countries bordering Yugoslavia." The Soviet Union until 1960, then seceded from the USSR and approached China that lasted until 1978, when it severed ties with China that led to the formula of self-isolation until 1991. Afterwards Albania would be the most isolated country in the world and would fanatically defend Marxism-Leninism and Stalinism that had been denounced by Khrushchev and Soviet Union.

The period of the fall of the communist regime and the emergence of political pluralism is one of the most important periods of recent national history. Although this is a short period, it is packed with many important events of a political, economic and cultural nature.

---

<sup>1</sup> Universiteti Nënë Tereza - Shkup

<sup>2</sup> Universiteti Nënë Tereza - Shkup

For more than four decades, respectively since the Second World War in Albania has ruled the Albanian Labour Party.

During the 80s the economic situation in Albania will become unbearable and after all the efforts made by the Albanian Labour Party to save the regime will not succeed and when the situation came to boiling point it erupted in December 1990. The situation was followed by much unrest until the pluralist political system emerged and the victory of the Democratic Party in March 1992 came to power.

**Keywords:** Communism, Albania, dictatorship, pluralism, democracy.

### **Shqipëria nga komunizmi në pluralizëm (1989 - 1992)**

#### **1. Hyrje**

Gjatë Luftës së Dytë Botërore u krijuan dy forca politike të rëndësishme: Partia Komuniste shqiptare në nëntor të vitit 1941 dhe Balli Kombëtar në fund të vitit 1942. Kishin qëndrime të ndryshme sa i përket realitetit dhe zhvillimeve të krijuar në kohë. Në njërin anë, ishte Enver Hoxha si kryekomunist dhe Mit'hat Frashëri në krye të nacionalistëve. Shikuar nga perspektiva e përgjithshme, shqiptarët qëndronin në bllokun antifashist, duke u mobilizuar ushtarakisht në këtë koalicion. Pushtimi gjerman krijoi një hapësirë përçarëse tek shqiptarët, tek faktori politik shqiptar dhe gjithë kjo si rezultat i ambicieve për të ardhur në pushtetin që pritej. Përçarjet e brendshme si duket kishin një faktor të jashtëm nxitës. Në krye të këtij procesi përçarës ishte udhëheqja komuniste shqiptare, e cila në bashkëpunim me përfaqësuesit e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë iu kundërvu me armë forcave nacionaliste dhe mbretërore të vendit.<sup>3</sup>

Kjo do të thotë se nga një front siç ishte ai Nacional-Çlirimtar, vendi po kalonte në fazën më të rrezikshme, në luftën civile. Kësaj hapësire i paraprinë lëvizja komuniste, ngase në aspekt të veprimit, sidomos te organizimit politik kishin dallim të madh dhe duke shfrytëzuar rrethanat e brendshme si dhe ndihmën që i vinte nga jashtë, pas çlirimit të Shqipërisë, force dominante ishin komunistët.

---

<sup>3</sup> Lisjen Bashkurti, Identiteti, imazhi dhe diplomacia, Kumanovë, 2006, f. 86.

Ardhja e komunizmit në Shqipëri ishte produkt i lëvizjeve të bren-dshme dhe i mbështetjes politike jugosllave. Asnjë mbështetje direkte politike dhe ushtarake nga Bashkimi Sovjetik nuk i erdhi Shqipërisë deri pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo për faktin se Bashkimi Sovjetik nuk solli gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri as përfaqësues politik dhe as Ushtrinë e Kuqe. Shqipëria ishte i vetmi vend socialist në Evropën Lindore që ishte çliruar krejtësisht me forcat e veta.<sup>4</sup> Zhvillimet e mëvonshme krijojnë paqartësi sa i përket kërkesave dhe strategjisë shtetërore në krye me Enver Hoxhën. Politikat e tij, orientimi jo i definuar, si dhe polarizimet e panevojshme politike si brenda po ashtu edhe jashtë shtetit do krijojnë pasiguri që do të ndikojë edhe në mospranimin në OKB-së. Duhet thënë se, barriera më e madhe ishte vetë regjimi shqiptar.<sup>5</sup>

Krijimi i politikave në vija të drejta, fillimisht me Jugosllavinë, Bashkimin Sovjetik dhe me Kinën do i kushtojë shumë Shqipërisë në aspiratat e saja. Pakti i Varshavës, po ashtu edhe minimi i Kanalit të Suezit do shtojnë barrierat edhe më tej. Në këtë periudhë, shteti shqiptar u përball me politikën më të keqe që kishte ndonjëherë, një politikë burgosëse dhe çorientuese për gjithë shqiptarët.

Bazuar në doktrinën marksiste-leniniste ky regjim dhe suita e tij në krye me diktatorin Enver Hoxha ka pasur marrëdhënie diplomatike të mira në fillim me ish-Jugosllavinë e Titos deri më vitin 1948, me të cilën prishi marrëdhëniet diplomatike duke shpallur Enver Hoxha se “Revizionistët jugosllavë nuk ishin as për paqen as për socializmin. Ata ishin lidhë këmbë e duar mbas imperialistëve dhe u ndihmonin me shkatërrue regjimet komuniste në shtetet fqinje me Jugosllavinë”.<sup>6</sup>

Historiani i mirënjohur Norman Davies në librin e tij “Historia e Evropës”, kur flet për prishjen e marrëdhënieve mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës nuk lë pa përmendur edhe Shqipërinë. Ai thekson se kjo ndarje pati ndikim të drejtpërdrejtë në vetëm një shtet të Evropës. Sikurse kinezët edhe shqiptarët kishin rezerva të rëndësishme ndaj destalinizimit... Ata morën “Rrugën e Kinës”: Tirana zëvendësoi lojalitetin ndaj Moskës me atë të Pekinit. Ajo ngeli plotësisht staliniste tërësisht e kolektivizuar dhe e ateizuar, nën izolim total gjithashtu edhe me fqinjët

<sup>4</sup> Lisjen Bashkurti, Identiteti, imazhi dhe diplomacia, Kumanovë, 2006, f. 87.

<sup>5</sup> Elmas Leci, Polemikë me një Diplomat, cikël artikujsh studimorë, Tiranë, 2005, f. 40.

<sup>6</sup> Tajar Zavallani, Histori e Shqipnis, Londër, 1966

e vet. Asgjë nuk ndryshoi në Shqipëri deri më vitin 1990. Religjioni i vetëm në Shqipëri që e deklaroi Enver Hoxha ishte “Të jesh shqiptar”.<sup>7</sup>

Se në çfarë niveli ishte sistemi politik në Shqipëri Uolltër Lakër vlerëson se “Shqipëria përbënte një përzierje kureshtare të komunizmit primitive dhe nacionalizmit, ku klanet luanin një rol kryesor”<sup>8</sup>

Regjimi komunist në Shqipëri me shtypjen që e kishte bërë mbi vet popullin e vet njëhej si një nga regjimet më të egra diktatoriale në botë. Tortura nga më të ndryshmet. “Kështu fle nën dhe, dhe mbushin burgjet diplomat e dijes dhe të lirisë të marra në Vjenë, Paris, Londër, Romë. Zhduken dyert e mëdha dhe pronat. Nis kalbëzimi i shpresës. Koha shqiptare e shënon humbjen e dinjitetit, porsa merr emrin “epoka e Partisë”, “epoka e Enver Hoxhës” dhe konkretisht ajo shënohet në antikohë, kur formula e spiunimit për “Ilogari të Partisë”, “interesave të saj”, apo Enver hoxhës, merr masën tragjike të përcaktimit të fateve njerëzore dhe më gjerë”.<sup>9</sup>

## **2. Pakënaqësitë dhe përpjekjet për rrëzimin e diktaturës komuniste**

Periudha kohore që fillon me vitet e 80 -ta dhe që do merr kahjen e plotë pas viteve 90-ta, përbën një nga periudhat me rëndësi historike, për vetë faktin se ngjarjet e bëjnë të natyrës më të rëndësishme, ngase ishin kohë vendimtare. Edhe pse vitet janë të pakta, por për nga domethënia dhe rëndësia përfshinë një rrugëtim mjaft domethënës.

Vdekja e Enver Hoxhës, por edhe zhvillimet e vrullshme politike në botë, sikur ishin revolucionet demokratike që shpërthyen në vendet e Lindjes e sidomos shembja e Murit të Berlinit nuk paraqisnin ndonjë domethënie të madhe për Ramiz Alia i cili jo vetëm nuk do të ndërmerre reforma për të ndryshuar sistemin brenda vendit dhe as politikën e tij të jashtme, por do të vijonte me konsekuencë trashëgimitë e Enver Hoxhës.<sup>10</sup> Sjellja e tij ishte vetëm përpjekje që të përshtatej situatave të reja për të mbajtur me çdo kusht pushtetin, duke ecur në binarët pa fund, me demagogji për të ndaluar një histori dhe një kulturë. Nga tre sfidat me të cilat do të ballafaqohej Ramiz Alia gjatë qeverisjes së tij që ishin varfëria, diktatura dhe izolimi, sfida e fundit, pra izolimi do të përbënte

<sup>7</sup> Norman Davies, Europe A Histori, 1997, London, f.1104

<sup>8</sup> Uollter Lakër, Evropa në kohën tonë, Tiranë 1996 f.437

<sup>9</sup> Fahri Balliu, “Berisha përmes Kasandrave”, Bari /Itali/, 1996, f.7

<sup>10</sup> Lisjen Bashkurti, Identiteti, imazhi dhe diplomacia, Kumanovë, 2006, f. 93.

sfidat më të vështira dhe kyçe për zgjidhjen edhe të sfidave të tjera. Izolimi kishte shkaktuar plagë të thella në mentalitetin e njerëzve të thjeshtë dhe të udhëheqësia e lartë; kishte hapur një hendek të madh në nivelin arsimor, kulturor, Teknik e shkencor [...] kishte krijuar sindromën e armiqve nga gjithë bota në popull e sidomos në forcat e armatosura, kishte mbjellë skepticizmin ndaj kujtdo e në çdo kohë...<sup>11</sup>

Realiteti i krijuar çoi deri te revolta e intelektualëve të ndryshëm, që në fakt përfaqësonin forca të reja dhe kërkonin ndryshime të shpejta dhe të thella demokratike, përsikaj asaj që Ramiz Alia ëndërronte të mbante në pushtet me çdo kusht Partinë e Punës.<sup>12</sup>

Vetë izolimi solli lindjen e një lloji shkallëzimi të marrëzisë: ndërtimi i bunkerëve në çdo disa metra përgjatë gjithë vijës kufitare; ndalimi i makinave si pronë private; ndalimi i detyrueshëm i mbajtjes së mjekrës; dhe, mbi të gjitha, hyjnizimi i dy burrave - Josif Stalinit dhe Enver Hoxhës - kujtimi i të cilëve mbeti i shenjtë deri më 1990, kur Shqipëria u trondit rëndë nga një zemërim popullor i grumbulluar gjatë një gjysme shekulli.<sup>13</sup>

Veprimtarët që për qëllim kishin ndryshimet ndërmorën veprime të guximshme kundër regjimit, kështu që në dhjetor të vitit 1989 u shpreh pakënaqësia ndaj regjimit dhe në janar të vitit 1990 u bënë përpjekje për heqjen e bustit që njëherit është edhe simbol i diktaturës, të Stalinit. Menjëherë pasuan arrestimet, u përdorë force për shtypjen e lëvizjeve demokratike. Ky veprim i regjimit bëri që shumë njerëz, rrugëdaljen të shohin jashtë kufijve të Shqipërisë, të ikin dhe ta lënë vendin. Mirëpo, regjimi nuk i la të qetë, duke vrarë edhe në kufi ata që donin të ikin.

Dukuri jo e zakonshme ishte hyrja në mënyrë individuale, ose në grupe në rezidencat e përfaqësive diplomatike në Shqipëri. Dita ditës erdhi duke u zgjeruar dhe u bë e papërballueshme për forcat e rendit, pra doli jashtë kontrollit. Kështu më 2 korrik 1990 turmat u nisën drejtë përfaqësive diplomatike dhe u futën brenda disa ambasadave. Në 4 korrik, shpërthejnë demonstrate e fuqishme, shpërthehen dyert e ambasadave, demonstruesit strehohen në to e kërkojnë azil politik.<sup>14</sup>

<sup>11</sup> Lisjen Bashkurti, *Diplomacia e Vetëizolimit*, GEER, Tiranë, 2004, f. 650 – 660.

<sup>12</sup> Mitro Çela, *Unë, politikani i dështuar*, Toena, Tiranë, 2017, f. 51.

<sup>13</sup> Misha Glenny, *Histori e Ballkanit, Nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha*, Pema, Prishtinë, 2019, f. 562

<sup>14</sup> Elmas Leci, *Polemikë me një Diplomat, cikël artikujsh studimorë*, Tiranë, 2005, f. 181 – 182.

### 3. Pluralizmi politik dhe krijimi i Partisë Demokratike

Të gjitha popujt e botës e ngrenë zërin kundër qeverive të tyre. Ato të vendeve të lindjes u inkurajuan në këtë drejtim nga propaganda që vinte nga Perëndimi. Të ngresh zërin për të kundërshtuar është gjë e lehtë, ndërsa e vështirë t'i japësh formë kritikës [...] rënia e regjimeve komuniste ngre dy pyetje të vështira: Ku qëndron fatkeqësia e popujve që iu nënshtruan atyre regjimeve? Çfarë thuhet se ndreq tranzicioni aktual?<sup>15</sup>

Ngjarjet që pasuan pas janë treguesja më e mirë dhe njëherit edhe iu përgjigjen pyetjeve të lartpërmendura. Studentët janë promotorët e lëvizjeve që për qëllim kanë ndryshimin. Edhe në Shqipëri lëvizjet studentore morën drejtimin e duhur, drejtim që do të sjellë edhe ndryshime rrënjësore. Gjithsesi se kësaj natyre i ndihmuan edhe punëtorët që në dhjetor do të mundësojnë zgjerimin e demonstratave edhe në mesin e popullsisë së disa qyteteve, si të Tiranës, Shkodrës, Durrësit, Kavajës. Premtimet kryesore të Lëvizjes Studentore në vitin 1990 ishin për një sistem të ri demokratik që do kishte si bazë lirinë e shprehjes dhe përfaqësimit ashtu siç kërkojnë standardet evropiane. Por edhe pse ky Dekret nuk kishte referenca të qarta mbi demokracinë e brendshme dhe as mbi normat e organizimit demokratik, bënë të largojnë sistemin komunist edhe atë pa bë rezistencë të madhe,<sup>16</sup> Ramiz Alia u detyrua të pranonte kërkesën e tyre për vendosjen e pluralizmit politik në Shqipëri. Me dekretimin e pluralizmit politik në dhjetor 1990, dhe pranimin e ekzistencës së partive të tjera politike përveç Partisë së Punës, në Shqipëri u krijuan kushtet për lindjen dhe funksionimin e një sistemi partiak konkurrues dhe institucional, me çka u bë një kalim i shpejt, ndryshim i butë sistemesh. Shqipëria nën drejtimin e Ramiz Alisë nuk u bë as Bukuresht dhe as Tienanmen. Me këtë akt, Ramiz Alia më në fund i vuri një degë ulliri në krye karrierës së tij politike komuniste.<sup>17</sup> Më 12 dhjetor të vitit 1990, në mjediset e studentëve të Universitetit të Tiranës, u krijua e para parti politike opozitare në Shqipëri - Partia Demokratike, presidenti i fundit komunist i Shqipërisë shpalli pluralizmin politik dhe fundin e diktaturës komuniste shqiptare.<sup>18</sup>

<sup>15</sup> Bernard Lory, *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona*, 2007, f. 219.

<sup>16</sup> Bernard Lory, *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona*, 2007, f. 219

<sup>17</sup> Lisjen Bashkurti, *Diplomacia e Vetëizolimit*, GEER, Tiranë, 2004, f. 658.

<sup>18</sup> Elmas Leci, *Polemikë me një Diplomat, cikël artikujsh studimorë*, Tiranë, 2005, f. 182.

#### 4. Lëvizjet e para antikomuniste

Edhe pse vetë Gorbaçovi në Bashkimin Sovjetik kishte filluar që të lëshojë pe dhe të fillojë me zbatimin e disa reformave, Ramiz Alia dhe komunistët shqiptarë e konsideronin atë revizionizëm dhe kishin bindjen se një gjë e tillë nuk mund të ndodhte në Shqipëri. “Duke ngulmuar se regjimi komunist gëzonte përkrahje të gjerë popullore, Ramiz Alia u bënte thirrje shqiptarëve që të nxirrnin mësim nga rreziku i ndjekjes së shembullit të bllokut sovjetik dhe të mos lejonin rivendosjen e kapitalizmit”.<sup>19</sup> Megjithëse përmbyjsja e regjimit të Çausheikut në Rumani e shqetësonte kllapën komuniste shqiptare, metodat brutale të të cilit nuk ishin asgjë në krahasim me ato të Enver Hoxhës. Një muaj para se të vritej Çausheiku, vetë ai kishte përjashtuar mundësinë që reformat e tilla të zbatoheshin në Rumani, por situata rrodhi ndryshe.

Më 14 janar 1990 në Shkodër demonstrues antiqeveritarë u përpoqën të rrëzonin statujën e Stalinit ku më pas ajo demonstratë u shua me dhunë. Më 28 janar në Tiranë u organizua nga studentët një miting i gjerë proteste të heshtur duke ngritur duart me shenjën e fitores. Në një Shqipëri që dikur s’kishte besim as ndërmjet burrit dhe gruas kjo mënyrë e protestës fliste shumë.

Tani PPSH po shikonte mundësitë se si të kapërcehej kjo situatë. Të fillohej me liberalizimin fillimisht të ekonomisë pastaj edhe në sfera të tjera të jetës duke i zbatuar ato gradualisht ndërsa kishte edhe zëra që po shikonin mundësinë e reformimit të Partisë së Punës nga brenda, duke e ndarë përfundimisht nga nomenklatura e PP-së dhe trashëgimia e saj negative<sup>20</sup>, por akoma as nuk vinte në konsiderim lejimi i një sistemi pluralist.

Fundi i vitit 1990 dhe fillimi i vitit 1991 shënoi ngjarjet më të rëndësishme që ndikuan drejtpërsëdrejti në diktimin e politikës së kohës. Situata sa vinte dhe bëhej kaotike. Pakënaqësia popullore për shkak të krizës ekonomike që vinte duke u keqësuar edhe më tej, moszbatimi i reformave të premtuara, kriza energjetike që i linte në terr shqiptarët me orë të tëra dhe mllefi i mbledhur antikomunist për dekada me radhë veç më filloi të shpërthejë në përmasa të gjëra duke mos dëgjuar tani as zërat e regjimit komunist të brishtë që mezi tani frymonte dhe as zërat e Opozitës demokratike që thërrisnin për qetësi me qëllim që mos të dilte situata nga kontrolli. Mitingjet e organizuara

<sup>19</sup> Elez Biberaj, “Shqipëria në tranzicion”, Tiranë, 2001, f. 63

<sup>20</sup> Servet Pëllumbi, “Dritëhije të tranzicionit”, Tiranë, 2000 f.9

demaskonin sistemin komunist dhe kërkohet përshpejtimi i proceseve demokratike. Më 20 shkurt 1991, pas një mitingu të madh në qytetin e Studentit, në klubin e të cilit studentët ishin mbyllur në grevë urie dhe kërkohet heqjen e emrit “Enver Hoxha” të Universitetit, një masë e madhe njerëzish u grumbulluan në sheshin “Skënderbej” të Tiranës dhe, pasi kapërcyen pengesat e forcave të rendit, rrëzuan monumentin e Enver Hoxhës. Tensioni rritet me shpejtësi, kulmuar me akte simbolike. Statuja e Stalinit rrëzohet në dhjetor, ajo e Enver Hoxhës në shkurt. Zgjedhjet e 31 marsit dhe 7 prillit 1991, të zhvilluara brenda një intervali të ngushtë kohe, ju japin fitore komunistëve (168 vende nga 250), shumë përpara Partisë Demokratike (75 vende) dhe organizatës Omonia të minoritetit grek (5 vende).<sup>21</sup>

Sido që të jetë edhe pse Partia Demokratike nuk mundi që të rrëzojë përnjëherë PPSH-në për shkak të arsyeve të lartpërmendura meqë vetë zgjedhjet u vunë në dyshim nëse ishin të rregullta, ajo arriti që t'i jep një grusht të rëndë këtij sistemi totalitar që kishte lëshuar rrënjë më se 45 vjet.

Merita kryesore qëndron në atë se Partia Demokratike pavarësisht nga përkrahja e fuqishme që kishte në popull sërish arriti që të mbajë gjakftohtësinë dhe nuk ra pre e skenarëve të kurdisura nga kuzhina të ndryshme dhe të përsëritej Rumania, bile thënë dhe më keq.

Pavarësisht nga fushata jo korrekte dhe sistemi zgjedhor që ishte përgatitur nga vetë komunistët për të siguruar fitoren, PD u shpreh se do të pranonte rezultatin dhe do të luante rolin e opozitës.

Ramiz Alia do të zgjidhet president me 172 vota në parlament. Ai ia dha mandatin Fatos Nanos të formonte qeverinë e re. Megjithëse ai u tregua se kishte energji dhe kapacitet të kontribuonte për të dalë nga situata që e kishte kapluar vendin sërish nuk do të ketë sukses. Reformat që ai i shpalli menjëherë përkundër tentimit për realizim të tyre nuk patën sukses. Qeveria u ballafaqua me një ekonomi që çintegrohej me shpejtësi; inflacioni po rritej rreth 260 % në muaj dhe 70 % e kraut të punës ishte pa punë. Ndihma financiare ndërkombëtare që iu premtua opozitës nëse do të fitonte nuk vinte. Më 15 maj, filloi edhe një grevë e përgjithshme e organizuar nga Sindikatat e Pavarura ku pas saj qëndronte Partia Demokratike e cila arriti të përfshinte 350.000 punëtorë.

---

<sup>21</sup> Bernard Lory, *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona*, 2007, f. 232 – 233.



Situata ishte kaotike. Sipas turmave në Tiranë greva tregoi se “qeveria mund të ketë parlamentin, por ne kemi gjithë vendin”.<sup>22</sup>

Ramiz Alia më nuk qëndronte pas Fatos Nanos. Më 4 qershor qeveria dha dorëheqje. Këtu morri fund sundimi absolut i PPSH për 47 vjet me radhë. Ramiz Alia tani ishte në kërkim të një emri që do të mundej më lehtë të afron opozitën dhe të kishte kapacitet të nxirrte vendin nga kjo humnerë. U ftua tani edhe opozita që të formonin bashkërisht “Qeverinë e Stabilitetit Kombëtar”. Më në fund Ylli Bufi u caktua kryetar i Këshillit të Ministrave në këtë qeveri. PPSH kishte 12 ministra në këtë qeveri, PD 7 ministra dhe 5 ministra i ndanë partitë më të vogla. Kjo ishte më shumë një qeveri për të plotësuar vakumin mes të rinjve, qytetit dhe fshatit, opozitës dhe komunistëve, deri sa të mbaheshin zgjedhjet e parakohshme vitin e ardhshëm.<sup>23</sup>

Partia Demokratike nuk pranoi të merrte pjesë në qeverinë e re. Qeveria e krijuar, u ballafaqua me vështirësi të shumta të karakterit politik shoqëror dhe ekonomik. PPSH-ja, që në qershor 1991 merr emrin Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Sekretar i së cilës bëhet Fatos Nano, nuk arrin të nxjerrë një ekip qeveritar të pranueshëm. Më së fundi, deri në zgjedhjet e ardhshme, formohet një qeveri e përkohshme koalicioni.<sup>24</sup>

## 5. Zgjedhjet e 22 marsit 1992 në Shqipëri

Si rezultat i luftës së opozitës, në radhë të parë studentëve dhe luftën e pakompromis të tyre dhe qëndrimit heroik të tyre, grevat dhe kërkesat e punëtorëve, të cilët kaluan edhe në greva urie, dhe në pamundësi për të drejtuar tensionet e krijuara në shtet, qeveria Nano ishte e detyruar që më 4 qershor 1991 të jep dorëheqje. Kështu perandoria e frikës dhe gënjeshtërsë edhe në Shqipëri vdiq, duke lënë pas burgjet, kampet e përqendrimit, varfërinë, cinizmin, urrejtjen e vese të tjera të cilat do ta ndjekin pas popullin për dekada, në rrugën drejt lirisë e përparimit.<sup>25</sup> U krijua qeveria e stabilitetit, dhe deri në dhjetor 1991 ishte qeveria e kryesuar nga Ylli Bufi, deri atëherë kur u larguan ministrat e

<sup>22</sup> James Pettifer dhe Miranda Vickers, “Shqipëria nga anarkia të një identitet ballkanik”, Tiranë, 1998, f.65.

<sup>23</sup> James Pettifer dhe Miranda Vickers, “Shqipëria nga anarkia të një identitet ballkanik”, Tiranë, 1998, f.65.

<sup>24</sup> Bernard Lory, *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona*, 2007, f. 233.

<sup>25</sup> Elmas Leci, *Polemikë me një Diplomat, cikël artikujsh studimorë*, Tiranë, 2005, f. 182.

Partisë Demokratike. Më pas u krijua një qeveri teknike (Janar 1992) e kryesuar nga Vilson Ahmeti, që do të drejtoj vendin deri në zgjedhjet e reja të parakohshme të 22 marsit 1992.

Atmosfera parazgjedhore paralajmëronte se 22 marsi do të shënonte ndryshim rrënjësor dhe historik në politikën shqiptare, si dhe tranzicioni shqiptar hyn në fazë të dytë.<sup>26</sup> Pa dyshim në këto zgjedhje do të luante rol të veçantë situata e rënduar ekonomike e vendit dhe demoralizimi i masave të gjera dhe besimin që socialistët përfundimisht e kishin humbur në popull.

Rritja e përkrahjes ndaj PD vinte edhe si rezultat i përkrahjes që iu dha asaj nga elita intelektuale shqiptare e Kosovës si brenda saj ashtu edhe nga mërgata.

Një faktorë tjetër i rëndësishëm që ndikoi drejtpërsëdrejti në fushatën parazgjedhore ishte edhe përkrahja amerikane ndaj PD ku dhe ambasadori i saj në Tiranë morri pjesë haptazi në mitingjet e PD. Vizitat e Berishës në SHBA dy herë për një vit dhe takimi me zyrtarë të lartë, vizita e sekretarit të SHBA-ve në Shqipëri James Baker me ftesë personale të Berishës gjithsesi flitnin qartë se tani priteshin ndryshime rrënjësore.

Rezultatet përfundimtare ishin të papritura dhe u tejkaluan dukshëm edhe parashikimet e opozitës. PD fitoi në 90 nga 100 zona zgjedhore, ndërsa PS pësoi humbje katastrofale duke fituar vetëm 6 zona zgjedhore. Bashkimi për të Drejtat e Njeriut fitoi 2 zona dhe Partia Socialdemokrate dhe Partia Republikane fituan nga një zonë zgjedhore. Ndërsa në sistemin proporcional ndarja e vendeve shkoi në favor të socialistëve dhe socialdemokratëve të cilët morën më shumë se 4% të votave në shkallë kombëtare. PS mori dhe 32 vende sipas sistemit përpjesëtimor dhe gjithsej arriti në 38 vende, ndërsa PSD mori dhe 6 vende plotësuese.

Më 9 prill më 96 vota për dhe 35 vota kundër Sali Berisha do të zgjidhet Kryetar i Shqipërisë.

Berisha më 10 prill emëroi kryeministër Aleksandër Meksin një arkeolog të njohur, por pa përvojë politike. Bashkim Koplaku dhe Rexhep Uka u emëruan zëvendëskryeministra. Ndërsa postin e kryetarit të parlamentit e mori Pjetër Arbnori.

---

<sup>26</sup> Bernard Lory, *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona*, 2007, f. 234.

## 6. Sfidat dhe reformat pas 22 marsit 1992

Parlamenti pluralist që doli nga zgjedhjet e 22 marsit 1992, ishte përballë shumë sfidave të natyrave të ndryshme. Faktori ekonomik paraqet sfidën më të madhe për shtetin Shqiptar që gëzonte lindjen e sistemit demokratik. U miratuan disa ligje që kishin të bëjnë me mbrojtjen e investimeve të huaja në Shqipëri, për privatizimin, për të drejtat e njeriut, u shkurtua koha e punës nga 48 orë në 40 orë në javë, privatizimi i tokave dhe kooperativave bujqësore dhe ajo e ndërmarrjeve bujqësore.

Edhe pse situata ekonomike dhe politike ishte mjaft e rënduar, sërisht tani do të arrihet që të organizohen zgjedhje më të lira dhe më demokratike. Për dallim nga zgjedhjet e '91 kur mbizotëronte frika për ndjekje të përkrahësve të opozitës nga policia dhe sigurimi, forcat e rendit ose qëndronin anash ose merrnin anën e opozitës. Mund të thuhet se këto ishin zgjedhjet më demokratike që ishin zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri.

Atmosfera parazgjedhore paralajmëronte se 22 marsi do të shënonte ndryshim rrënjësor dhe historik në politikën shqiptare, si dhe tranzicioni shqiptar hyn në fazë të dytë.<sup>27</sup> Pa dyshim në këto zgjedhje do të luante rol të veçantë situata e rënduar ekonomike e vendit dhe demoralizimi i masave të gjera dhe besimin që socialistët përfundimisht e kishin humbur në popull.

Rritja e përkrahjes ndaj PD vinte edhe si rezultat i përkrahjes që iu dha asaj nga elita intelektuale shqiptare e Kosovës si brenda saj ashtu edhe nga mërgata.

Një faktorë tjetër i rëndësishëm që ndikoi drejtëpërsëdrejti në fushatën parazgjedhore ishte edhe përkrahja amerikane ndaj PD ku dhe Ambasadori i saj në Tiranë morri pjesë haptaz në mitingjet e PD. Vizitat e Berishës në SHBA dy herë për një vit dhe takimi me zyrtarë të lartë, vizita e sekretarit të SHBA-ve në Shqipëri James Baker me ftesë personale të Berishës gjithsesi flitnin qartë se tani priteshin ndryshime rrënjësore.

Rezultatet përfundimtare ishin të papritura dhe u tejkaluan dukshëm edhe parashikimet e opozitës. PD fitoi në 90 nga 100 zona zgjedhore, ndërsa PS pësoi humbje katastrofale duke fituar vetëm 6 zona zgjedhore. Bashkimi për të Drejtat e Njeriut fitoi 2 zona dhe Partia Socialdemokrate dhe Partia Republikane

<sup>27</sup> Bernard Lory, *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona*, 2007, f. 234.

Fituan nga një zonë zgjedhore. Ndërsa në sistemin proporcional ndarja e vendeve shkoi në favor të socialistëve dhe socialdemokratëve të cilët morën më shumë se 4% të votave në shkallë kombëtare. PS morri dhe 32 vende sipas sistemit përpjestimor dhe gjithsej arriti në 38 vende, ndërsa PSD morri dhe 6 vende plotësuese.

Më 9 prill më 96 vota për dhe 35 vota kundër Sali Berisha do të zgjidhet Kryetarë i Shqipërisë.

Berisha më 10 prill emëroi kryeministër Aleksandër Meksin një Arkeolog të njohur por pa përvojë politike. Bashkim Kopliku dhe Rexhep Uka u emëruan zëvendëskryeministra. Ndërsa postin e kryetarit të parlamentit e mori Pjetër Arbnori.

Kjo fitore bindëse e Partisë Demokratike hapi një faqe të re në historinë kombëtare dhe perspektiva të reja për shqiptarët të cilët përfundimisht ndaheshin nga e kaluara e zyrtë dhe po ripozicionoheshin në drejtim të Evropës Perëndimore dhe SHBA-ve.

Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar Ramiz Alia në një deklaratë në RTV Kombëtar tha se “jepte dorëheqje për të mirën e kombit”. Parlamenti dorëheqjen e tij e miratoi pa kurrfarë debati. Kjo mënyrë e daljes së Ramiz Alisë, pasardhësit të diktatorit Hoxha nga politika shqiptare në mënyrë të heshtur, mospërfillëse dhe përcjellja pa ceremoni e një “burrështetasi” i cili kishte qenë në hierarkinë më të lartë shtetërore për rreth 47 vjet, shënonte fundin e një periudhe diktatoriale të pashembullt gati pesë decenie që kishin përjetuar shqiptarët.

Reformat e ndërmarra në fushën politike u mirëpritur në arenën ndërkombëtare, që forcuan pozitën e Shqipërisë, e cila më 29 qershor të vitit 1995 u pranua si anëtare në Këshillin e Evropës, si dhe shleu borxhin e regjimit.

## Conclusions

These riots in Albania were happening at a time when great changes were taking place throughout Eastern Europe. In the socialist states of Eastern Europe, the one-party system had already ended and plural political life had begun. Undoubtedly these events were reflected in Albania. This type of information was now provided through foreign media reporting on the situation in Eastern Europe and in Albania itself, as the media in the country were still kept under strict control.

Despite the scenarios staged by the Albanian Labor Party, the security organs, and in general the state structures, the democratic

movement proved tireless and invincible. She did not give up despite the sacrifices they made. The epilogue of all these riots brought democracy to Albania and finally the communist dictatorship fell. In this important event, however, the Western international factor gave support to these democratic movements. They openly supported the Democratic Party, though it is even worth mentioning the case of the American ambassador to Albania who participated in the PD rallies.

There is a conclusion that the period in 1989-1992, despite being short, occupies a special chapter in national history. It combines the interests of different strata of the people with different ideological views. A special role will be played by the communist structures that will make maximum efforts to survive on their own through the survival of the ALP and the communist system in general and the decorative movement that originated among the students and quickly spread to the masses. These student movements, which were later supported by the genuine intellectual strata, will cause headaches to Ramiz Alia and his collaborators who will use any form of pressure on the student movement for democracy. The more the pressure on the Democratic Movement increased, the more its mass support increased. This took the situation out of control and a serious situation prevailed in Albania.

The attempt by the ALP to defend the communist system and the unnecessary delays they caused in allowing political pluralism in Albania led to the total failure of the entire state system and consequently increased the suffering of the people.

However, it is important to note that the leaders of the democratic process in Albania did not tire and agreed to make the sacrifice of time just to liberate the country from that savage communist regime and at the same time, although with a little delay, Albania pursued the social changes that were taking place in Central and Eastern Europe.

Eventually, Albanians would feel free and organized in political parties, which means freedom of thought, freedom of expression and political freedom, which had been a "Forbidden Apple" for Albanians for more than 47 years.

**Recensentë:**

Prof. dr. Fehari Ramadani

Prof. dr. Enver Abdullahu

**Referencat:**

- Lory, Bernard, *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona*, 2007.
- Leci, Elmas, *Polemikë me një diplomat, cikël artikujsh studimorë*, Tiranë, 2005.
- Balliu, Fahri, “Berisha përmes Kasandrave”, Bari /Itali/, 1996.
- Pettifer, James dhe Vickers, Miranda , “Shqipëria nga anarkia të një identitet ballkanik”, Tiranë , 1998.
- Bashkurti, Lisjen, *Diplomacia e Vetëizolimit*, GEER, Tiranë, 2004.
- Bashkurti, Lisjen, *Identiteti, imazhi dhe diplomacia*, Kumanovë, 2006.
- Glenny, Misha, *Histori e Ballkanit, Nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha*, Pema, Prishtinë, 2019.
- Çela, Mitro, *Unë, politikani i dështuar*, Toena, Tiranë, 2017.
- Davies Norman, *Europe A Histori*, 1997, London.
- Pëllumbi, Servet, “Dritëhije të tranzicionit”, Tiranë.
- Zavallani, Tajar, *Histori e Shqipnis*, Londër, 1966.
- Lakër Uollter, *Evropa në kohën tone tiranë* 1996.